



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2020:108596

Datë: 13.11.2024

Numri i dokumentit: 06447034

C.nr.1590/2024

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, gjyqtari Nexhat Aliu, me sek. juridike Azize Rama, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, rr.lidhja e Pejës, magj. Prishtinë –Fushë Kosovë, pa nr, e kundër të paditurit E.Z., nga fshati N., K.Viti, baza e kontestit, kompenzim i dëmit material, dhe jomaterial, vlera e kontestit 745/2019 Euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 13.11.2024, bie këtë:

A K T G J Y K I M
Për shkak të padëgjueshmërisë /mosbindjes/

I. APROVOHET kërkespadija e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, rr.lidhja e Pejës, magj. Prishtinë –Fushë Kosovë, pa nr, **DETYROHET** i padituri E.Z., nga fshati N., K.Viti, që paditëses të ja paguaj borgjin në shumë prej 667.00 euro, (gjashqinegjashtdhjet e shtat euro), si dhe shpenzimet e procedurës për takës gjyqësore në shumë prej 20 Euro.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbartimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, rr.lidhja e Pejës, magj. Prishtinë –Fushë Kosovë, pa nr, ka ushtruar padi në këtë Gjykatë me dt.04.09.2020, kundër të paditurit E.Z., nga fshati N., K.Viti, që paditëses të ja paguaj borgjin në shumë prej 667.00 euro, me bazë të kontestit, kompenzim i dëmit material, me vlerë të kontestit 667.00 Euro.

Gjykata të paditurit E.Z., nga fshati N., K.Viti, konform dispozitave të LPK-së, me datën 04.11.2024, ia ka dorëzuar padinë në përgjigjeje, por nuk iu kishte bindur Aktvendimit dhe përgjigjejes në padi.

Pasi që i padituri nuk ka paraqitur fare përgjigjeje ne padi, Gjykata duke aplikuar nenin 111 parag. 1 dhe nenin 150, paragrafi 1 pika a dhe b, të LPK-se, lidhur me nenin 388, të LPK-se, bie Aktgjykim, për shkak të pa dëgjueshmërisë- mosbindjes së të paditurit.

Andaj Gjykata vendosi si në dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË VITI
C.nr.1590/2024
Më: 13.11.2024.

Gjyqtari
Nexhat Aliu

UDHËIM PËR MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nëpërmes të kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2020:108596
Datë: 13.11.2024
Numri i dokumentit: 06447034